



Fëmija im është gati!

Si do të fillojë fëmija im?

Akademia Virtuale e Filadelfias, është duke pranuar regjistrime për vitin shkollor 2013-14. Përpara fillimit të vitit shkollor, ofrohen shumë mundësi për njohjen me çka ofron Akademia Virtuale e Filadelfias:



Ne i inkurajojmë nxënësit dhe familjet të bëjnë një vizitë të hapur - personalisht, ose në mënyrë virtuale- që të takojnë stafin dhe mësuesit, të cilët do të mbështesin mësimin gjatë vitit shkollor.

Kur ju të jeni të gatshëm të futeni në këtë shkollë, regjistrimi është i thjeshtë, një proces hap-pas-hapi. Ka disa gjëra të cilat ju si familje duhet t'i paraqitni përpara drejtorisë; për çështjet e tjera do të kujdeset ekipi ynë i PVA, që fëmija juaj të vendoset në klasat dhe programet e duhura. Le t'i shikojmë këto gjëra bashkarisht:

1. Plotësimi i Formularit të duhur të PVA. Formulari fillestar për regjistrim është online në <http://www.philasd.org/language/albanian/pva>. Ky formular përmbledh informacionin bazë dhe lejon personelin tonë t'ju kontaktojë në lidhje me regjistrimin në PVA.

Kush e plotëson këtë shkallë?
 Ju (prindi ose kujdestari) e plotësoni këtë shkallë.

2. Rishikimi i Edukimit Special. Do të organizohet një takim i ekipit të IEP për të gjithë nxënësit e interesuar me një Plan Mësimor të Individualizuar (IEP), që do të garantojë, se synimet e IEP mund të realizohen në PVA. Në rast që ekipi konkludon se vendosja në PVA është siç duhet, do të dërgohet një Njoftim për Vendosjen e Rekomanduar (NOREP), që do të firmoset nga prindi. Mësues të Edukimit Special të certifikuar do të shërbejnë si menaxherë të rastit, duke ofruar mbështetje mësimore direkte për nxënësit, në shtesë të mësuesve që udhëzojnë përmbajtjen e lëndës, duke garantuar modifikimet e nevojshme të lëndës sipas kërkesave të IEP.

Ekipi ynë i Edukimit Special të PVA, bashkërisht me ju (prindi/kujdestari) do të plotësojnë këtë shkallë.

3. Vendosja e Nxënësve që Mësojnë Anglisht. Sasia e madhe e kërkesave online për leximin dhe shkrimin, mund të jenë të vështira për Nxënësit që Mësojnë Anglisht (ELLs). Rekomandohet që nxënësit ELL, të regjistruar për shkolla online, të demonstrojnë që janë të gatshëm nëpërmjet rezultateve në notat e provimit si më poshtë:

Kush e plotëson këtë shkallë?
 Ju (prindi ose kujdestari) e plotësoni këtë shkallë.

- Aftësi të mjaftueshme në përdorimin e gjuhës Angleze, me një notë mesatare prej 3.5 ose më lart në testet Wida Access Test, ose Wida Access Placement Test (W-APT); dhe
- Aftësi të mjaftueshme në shkrim-lexim të gjuhës Angleze, me një notë mesatare në kompozim prej 3.5 ose më lart në testet Wida Access Test, ose W-APT.

Nxënësit do të vlerësohen, që të përcaktohet një plan i programuar i Gjuhës Angleze si mësim i Gjuhës së Dytë (ESL) për të lehtësuar përvetësimin e aftësive gjuhësore dhe ofruar program mësimor në përshtatje me nivelin e zhvillimit dhe atë mësimor të nxënësit Përshtatshmëria e nxënësit ELL në klasën online do të vendoset duke u nisur nga notat e marra në testet Wida Access, ose W-APT.

Programet me kohë të plotë online nuk rekomandohen për nxënësit ELL, niveli i notave të të cilëve është më poshtë se 3.5 në testet WIDA Access Test, ose W-APT. Megjithatë, programet mësimore online, mund të ofrohen që të përdorin individualizim të kurrikulës dhe mësimëve për Nxënësit që Mësojnë Anglisht, notat e të cilëve në kompozim janë 3.5 ose më të larta me një notë minimale në kompozim të shkrim-leximit prej 3.5, në testet WIDA ACCESS ose W-APT.

FAQ

Kush mund të vazhdojë PVA? Mund të vazhdojnë PVA, nxënësit nën moshën 21 vjeç, që janë rezidentë të Drejtorisë Arsimore të Filadelfias (SDP) dhe që janë në klasat 6-12 dhe kanë plotësuar me sukses klasën e 5të deri në datën 1 Shtator 2013.

(vazhdon në faqen tjetër)

4. **Paraqitja e dokumentave të kërkuara.** Dokumentat e kërkuara për regjistrimin e fëmijës tuaj janë si më poshtë. Ju lutemi i sillni këto dokumenta në adresën 440 N. Broad Street, që të regjistroni fëmijën tuaj në PVA. Për më tepër informacion ju lutemi lini një mesazh zanor në numrin **215-400-8480**.

NE RAST SE TRANSFEROHENI NE PVA NGA NJE DREJTORI ARSIMORE TJETER:

Kush e plotëson këtë shkallë?

Ju (prindi ose kujdestari) e plotësoni këtë shkallë.

- Prova e Moshës (Çerfikatë Zyrtare e Lindjes, Çerfikatë e Pagëzimit, deklarata e noterizuar e prindit, ose e një të afërmi tjetër që vërteton datën e lindjes, pasaportë e vlefshme, rekorde të shkollës së mëparshme që tregojnë datën e lindjes)
- Prova e Vendbanimit (Dy (2) nga dokumentat e mëposhtëme: Tapia e Shtëpisë, kontrata e qirasë, fatura aktuale e energjisë, gazit ose ujit, fatura aktuale e kredit kartës, fatura e taksës së pasurisë, regjistrimi i makinës, patenta, ID e DOT);**
- Rekordet e Vaksinimit (Deklaratë me shkrim nga drejtoria arsimore e mëparshme, ose nga zyra mjekësore, ku mbahen këto rekorde, ose që këto janë në vazhdim, ose një garanci verbale nga drejtoria e mëparshme arsimore, apo zyra mjekësore, që vaksinimet e kërkuara janë kryer, dhe rekordet do të dërgohen në vazhdim.);**
- Pyetësor i Gjuhës Amtare (plotësohet online për nxënësit që regjistrohen për herë të parë);**
- Nxënësit e klasave të 6ta-9ta: Dëftesa më e fundit;
- Nxënësit e klasave të 10ta-12ta: Një transkript jo zyrtar nga shkolla e juaj e mesme aktuale, që tregon arritjet dhe klasat e plotësuara;
- Për nxënësit me IEP ose me IEP për Talentet (Gifted IEP) ose (GIEP), dërgohen të dy formularët e mëposhtëm:
 - Një kopje e IEP aktuale të nxënësit (Individualized Education Plan) ose Gifted IEP, dhe
 - Raporti i Vlerësimit (Evaluation Report) (i vlefshëm për tre vite);
- Për nxënësit me plan 504 (Medical Accommodations): Një kopje e Planit të Akomodimit 504 aktual (504 Accommodation Plan).

(vazhdon në faqen tjetër)

- Formulari i Transferimit Vullnetar - Ett-36 (Sepse ju zgjidhni të vazhdoni këtë shkollë në vend të shkollës që është më pranë jush, të Drejtorisë Arsimore të Filadelfias, regjistrimi juaj konsiderohet si Transferim Vullnetar);**
- Nxënësit e klasave të 6ta-9ta: Dëftesa më e fundit;
- Nxënësit e klasave të 10ta-12ta: Një transkript jo zyrtar nga shkolla e juaj e mesme aktuale, që tregon arritjet dhe klasat e plotësuara;
- Për nxënësit me IEP ose me IEP për Talentet (Gifted IEP) ose (GIEP), dërgohen të dy formularët e mëposhtëm:
- Një kopje e IEP aktuale të nxënësit (Individualized Education Plan) ose Gifted IEP, dhe
 - Raporti i Vlerësimit (Evaluation Report) (i vlefshëm për tre vite);
- Për nxënësit me plan 504 (Medical Accommodations): Një kopje e Planit të Akomodimit 504 aktual (504 Accommodation Plan).

Kush e plotëson këtë shkollë?
 Ju (prindi ose kujdestari) e plotësoni këtë shkollë.

5. Plotësimi i Provimeve të Pranimit në PVA. Caktimi i kujdeshëm i nxënësve në klasat e duhura, është esenciale për suksesin e tyre të mëtejshëm online. Provimet e PVA për Caktimin e Klasave, garantojnë që nxënësi është regjistruar në kurset online në përputhje me aftësitë e tij.

Provimet e PVA janë për lëndët bazë të gjuhës, matematikë, shkencë dhe histori; ka teste diagnostikuese në Aftësitë e Gramatikës Angleze dhe Matematikës. Përpara regjistrimit në Akademi janë të kërkuara vetëm testet diagnostikuese në Anglisht dhe Matematikë; në rast se nxënësi planifikon të vazhdojë lëndë të tjera, nga ata mund të kërkohet të kalojnë këto teste specifike gjatë regjistrimit.

Provimet kërkojnë afërsisht 30 minuta kohë për secilin. Në vazhdim të testit, ekipi ynë i regjistrimit do të rekomandojë një nga katër nivelet e secilit kurs, që do të ndjekë fëmija juaj:

Kush e plotëson këtë shkallë?
 Ju (prindi ose kujdestari) e plotësoni këtë shkallë.

1	2	3	4
<p>Niveli Bazë (Anchors/ Foundation level) i klasave është versioni themelor i përmbajtjes së klasave origjinale, për leximin dhe kuptimin sa më të thjeshtë të koncepteve</p>	<p>Niveli i Përgatitjes për Kolegj (College Preparatory level) i klasave janë klasat origjinale dhe tradicionale, që janë përcaktuar për nivelin e klasës</p>	<p>Niveli i Dalluar (Honors level) i klasave ofron aktivitete të pasura dhe një shënim i Dalluar (honors) në transkriptet e nxënësit</p>	<p>Niveli i Avancuar (AP) i klasave ofron mundësinë të fitosh kredite të shkollës së lartë në përfundim të lëndës, duke kaluar testin e AP.</p>

FAQ

A duhet që fëmija im t'i marrë të gjitha klasat në të njëjtin nivel? Jo; fëmija juaj mund të testohet në nivelin bazë (Anchors) në një klasë dhe në nivelin i dalluar (Honors) në klasën tjetër. Kjo është normale për PVA dhe ne do ti regjistrojmë ata në secilën klasë që përshtatet më mirë me kërkesat e tyre, në nivelet që kanë nevojë për korrigjim, ose të avancuara.

FAQ

A duhet që fëmija im të marrë një minimum pikësh në test që të regjistrohet në PVA? Në shumicën e rasteve nuk kërkohet një minimum pikësh. Megjithatë, kurset tona të larta janë përpunuar për nxënësit që janë në nivelin e klasës së 7të ose më mirë. Klasat e shkollës tetëvjeçare janë përpunuar për nxënësit e nivelit të klasës së 5të, ose më mirë. Në rast se testet e fëmijës tuaj janë në mënyrë të dukëshme mbrapa nivelit të klasës në aftësitë matematike ose në lexim, ne mund të sugjerojmë që klasat e PVA online, nuk janë vendi i duhur për atë, pasi që mësimi online ka lexim intensiv. Kjo mbetet të diskutohet me ju dhe të vendoset rast pas rasti; nxënësit që janë mbrapa nivelit të klasës, por janë të përshtatshëm për studimin online, mund të marrin mbështetje nga akademia, që u mundëson atyre të arrijnë sukses.

Keni pyetje të tjera rreth procesit të regjistrimit? Ju lutemi lini një mesazh zanor në numrin **215-400-8480**, ose shkruani në Qendrën tone Ndihmuese www.philasd.org/language/albanian/help dhe ne do t'ju kontaktojmë në rastin më të pare.